



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:256990

Datë: 05.08.2020

Numri i dokumentit: 01051521

P. nr.1106/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit O.L , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.2477/19 të dt.29.11.2019 për shkak të veprës e penale : Blerja , pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par 2 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit O . L dhe të prokurorit të shtetit Ardiana Veseli , me dt.05.8.2020 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri O. L i lindur me dt... në Pejë rruga “...” nr. ... , ku edhe tani jeton, i biri i K dhe nënës Sh e gjinisë I , i njohur me dokument identifikues numër .. ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë , i martuar baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës , kinse i pa dënuar nga gjykata, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se :

me dt. 02.9.2019, në kohë të pacaktuar , në Pejë në rrugën “...” nr. ..., blenë sendin të cilin e ka munduar ta dijë se është i përfituar me kryerjen e veprës penale , në atë mënyrë që i pandehuri pranon që datën e lartcekur të ketë blerë 15 apo 20 paketime gurë të shllajfericave të markës M , prodhim kinez , nga personi B. K në vlerë prej 50 euro, të cilat sende pastaj me rastin e bastisjes në shtëpinë e ti janë gjetur dhe konfiskuar nga ana e policisë

-me çka ka kryer veprë penale Blerja , pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par 2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 345 par 2 të KPRK-së. I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro , kurse në emër të taksës për mbrojtjen e viktimave të krimit shumën prej 30 euro - të gjitha këto 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.29.11.2019, kundër të pandehurit O. L , ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2477/19 për vepër penale : Blerja , pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par 2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë i ka pranuar.

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë që paraqet rrethanë veçanërisht lehtësuese , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, , e në veçanti faktin se gjësendet në fjalë i janë kthyer të dëmtuarit D. K i cili në deklaratën e tij në dhënë në polici me dt. 10.10.2019 personalisht ka deklaruar se : “këto gjësende kanë qenë me afat të skaduar dhe nuk kanë qenë për shitje” dhe kësioj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi obligimin e të pandehurit për taksat për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë konform Ligjit nr. 05/L-036

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.05.8.2020.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .